



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva, Trgovine i Inovacija, Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and
Innovation*

RREGULLORE (MINTI) Nr. 01/ 2026
PËR DUKJEN, PAJISJEN DHE PËRDORIMIN E UNIFORMËS SË
INSPEKTORATIT QENDROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Rregullore (MINTI) Nr. 01/ 2026 për dukjen, pajisjen dhe përdorimin e uniformës së Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, është miratuar me Vendimin Nr.01/101, Datë. 30.06.2026

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 34, 18 Nëntor 2022),

Miraton:

RREGULLORE (MINTI) Nr. xxx/ 2026
PËR DUKJEN, PAJISJEN DHE PËRDORIMIN E UNIFORMËS SË
INSPEKTORATIT QENDROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e dukjes, pajisjes dhe përmbajtjes së uniformës nga inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Neni 2
Fushëveprimi

- 1.Kjo Rregullore zbatohet nga Inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.
- 2.Të gjithë inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut gjatë inspektimit duhet të bartin uniformën e përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3
Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Stema** - nënkupton përcaktimin grafik të shenjës identifikuese të institucionit që e dallon atë nga një institucion tjetër;
 - 1.2. **Uniformë** – nënkupton jelekun zyrtar të standardizuar, e përcaktuar sipas këtij akti nënligjor, që mbahet detyrimisht nga inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut gjatë ushtrimit të funksionit, detyrës apo shërbimit të tyre, e cila shërben për identifikim, dallim funksional dhe paraqitjen institucionale;
2. Të gjitha termat e përdorura në këtë Rregullore e kanë kuptimin e njëjtë si në ligjin përkatës për inspektime, ligjin përkatës të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut si dhe ligjet e tjera në fuqi.

3. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në njëren gjini, nënkuptojnë edhe gjininë tjetër, dhe njëjësi nënkupton shumësin.

KAPITULLI II

UNIFORMA E INSPEKTORATIT QENDROR TË MBIKËQYRJES SË TREGUT

Neni 4

Dukja dhe përmbajtja e uniformës së Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

1. Uniforma e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut përbëhet nga jeleku.
2. Uniforma e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, dallohet në dy sezona, në atë verore dhe dimërore.
3. Uniforma e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut ka ngjyrën e zezë, përjashtimisht stemës e cila ka ngjyrat e stemës së Republikës së Kosovës dhe tekstit që vendosen në uniformë duhet të shkruhet me ngjyrë të bardhë.
4. Uniforma e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut përmbanë stemën e Republikës së Kosovës e cila vendoset në krahun e djathtë, por që shikuar përpara i bie ana e majtë dhe, nën të shënohet teksti “Republika e Kosovës” dhe emri i Ministrisë përkatëse për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, si dhe stemën e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut e cila vendoset në krahun e majtë dhe nën të shënohet teksti “Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut”, kurse në pjesën e pasme të uniformës vendoset akronimi I.Q.M.T.

Neni 5

Pajisja me uniformë të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

1. Pajisja me uniforma bëhet me kohë dhe në mënyrë të rregullt, sipas nevojës së inspektorëve të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.
2. Pajisja me uniforma për inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut bëhet përmes procedurave të prokurimit publik.

Neni 6

Përdorimi i uniformës së Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

1. Inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut duhet të mbajnë uniformën të mbërthyer, të pastër si dhe të përshtatshme për punë, ndërsa gjatë mbajtjes së uniformës pjesa tjetër e veshjes duhet të jetë serioze për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Paraqitja dhe dukja e inspektorëve të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut gjatë kryerjes së detyrave zyrtare duhet të pasqyrojë një imazh profesional dhe zyrtar ashtu që të mos e dëmtoj imazhin e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

3. Inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut gjatë inspektimit duhet të mbajnë edhe kartelën identifikuese në mënyrë të dukshme në pjesën e sipërme të uniformës apo të varur rreth qafës.

4. Për inspektorët e gjinisë mashkullore është e ndaluar mbajtja e stolive në mënyrë të dukshme, përjashtimisht mbajtja e orës dhe një unaze me madhësi normale.

5. Për inspektorët e gjinisë femërore është e ndaluar mbajtja e stolive në mënyrë të dukshme, përjashtimisht mbajtja e vathëve, unazave, orës, zingjirë dore të cilat duhet të jenë të madhësisë normale.

Neni 7 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj rregullore e bënë Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut.

2. Nëse inspektori i Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut bën shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje, konsiderohet se ka bërë shkelje disiplinore dhe ndaj tij do të inicohet procedurë disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (MTI) - Nr. 01/2016 për uniformat dhe përdorimin e tyre nga inspektorët e tregut.

Neni 9 Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 30.06.2026

Mimoza KUSARI LILA

Ministre në detyrë

